



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 25.

Prishtinë, më 6 korrik 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Adem Hajdaraj, Ibrahim Makolli, Kolë Berisha dhe Džezair Murati.

Munguan: Selvije Halimi, Armend Zemaj dhe Branislav Gerbiq.

Të pranishëm: Lejla Selimi – OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Ramadan Islami - OSBE, David Wolstenholme -EU-AC, Delphine Freynann - Komisioni European, Yordan Sirakov, Vlora Marmullakaj dhe Blerta Ukmata – EULEX, Lumnije Murati – ZPRK, Driton Selmanaj – KDI, Alban Sutaj – Ministria e Drejtësisë, Sefer Goxhuli dhe Mentor Borovci- Agjencia Kundërkorrupsionit, Xhemajl Peqani dhe Nesrin Lushta – KQZ , Nexhmi Rexhepi - ICO dhe Visar Krasniqi - Kuvendi i Kosovës.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 29 qershorit 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës të KQZ-së për vitin 2008,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit kundër korrupsionit;
6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit, Riza Smaka, për rishikimin e përfundimit të

Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi,
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit, drejtoreshën e KQZ –së, kryeshefin e ekzekutivit të KQZ -së, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të Agjencisë Kundërkorrupsionit, të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, të Zyrës së EULEX –it, si dhe të atyre që e përcjellin punën e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 29 qershorit 2009

Kryetari- I pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë vërejtje rreth procesverbalit.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës të KQZ-së për vitin 2008

Kryetari – I njoftoi të pranishmit për përmbajtjen e Raportit të KQZ-së, që për herë të parë i paraqesin raport Kuvendit të Kosovës, sepse deri tash ka qenë në kompetencat e faktorit ndërkombëtar.

Raporti ka vërejtje në aspektin teknik, përmbajtjesor, si dhe ka përshkrime të panevojshme, por me rendësi është se i plotëson kushtet për t'u shqyrtuar në séancë plenare.

Ftoi drejtoreshën e KQZ-së ta marrë fjalën.

Nesrin Lushta - Falënderoi anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit. E njoftoi Komisionin për përmbajtjen e këtij raporti, duke iu referuar dispozitave ligjore, sipas të cilave është themeluar KQZ-ja, funksionimin e KQZ –së, kush janë anëtarët e saj, funksionimin e KQZ-së në këshilla, Sekretariatit, komisionet komunale, si dhe zyrat për regjistrimin e partive politike.

Duke shtuar se i mirëpret vërejtjet dhe sugjerimet për përmbajtjen e Raportit, në mënyrë që në të ardhmen të ketë formë dhe përmbajtje më të plotë.

Kryetari – Hapi debat për këtë pikë.

Adem Salihaj – Në diskutimin e tij ngriti çështjen e shpenzimeve telefonike, që ka bërë KQZ-ja, çështjen e mëditjeve brenda vendit, si dhe takimet e mbajtura jashtë vendit, duke i cilësuar më tepër si luks, sesa nevojë, kur ato kanë mund të bëhen edhe në Kosovë.

Bajram Kosumi – Për Raportin shtoi se në të janë përfshirë çështje që nuk është dashur, ndërsa mungojnë ato që është dashur të përfshiheshin. Ishte i kënaqur me hartimin e 14

rregullave zgjedhore, por në vazhdim ngriti çështjen se a ka kapacitete KQZ-ja të organizojë dhe t'i mbikëqyrë zgjedhjet? Po ashtu e theksoi nevojën që KQZ-ja të nxjerrë rregulla zgjedhore plotësuese për punën e vet, për kandidimin e zyrtarëve të lartë politikë. Këto rregulla do ta specifikonin nominimin e anëtarëve për komisionet komunale nga ana e partive politike. Vuri në pah se KQZ-ja ka nevojë për përkrahje nga ekspertët, në radhë të parë nga OSBE-ja, si dhe ngriti çështjen e heqjes së votimit me kusht.

Ibrahim Makolli – Duke folur rreth Raportit ceku bllokimin e KQZ –së, që është shkaktuar nga ana e përfaqësuesve të partive politike, që kanë shkaktuar pengesa në funksionimin e tij. Pyeti si është gjendja e komisioneve komunale, a janë kompletuar dhe cili është funksioni i tyre? A është KQZ –ja e gatshme, me këtë kapacitet që ka, t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme në rast nevoje? Çka ka ndodhur në 40 vendvotime, në të cilat janë anuluar zgjedhjet e kaluara? Pse nuk janë bërë publike listat e kandidatëve me votat e fituara? Cila është gjendja me listën e votuesve dhe si është siguria e votës?

Džezair Murati – E përshëndeti drejtoreshën, praninë e saj e cilësoi si të rrallë. U pajtua me parafolësit rreth shpenzimeve telefonike dhe të udhëtimit duke i cilësuar si të larta. Praninë e KQZ-së të Bosnjës e Hercegovinës, të Maqedonisë dhe të Shqipërisë e cilësoi si përvojë të mirë. Ndërsa për cilësimet që janë bërë për boshnjakët dhe goranët, i cilësoi si jo të drejta, sepse nuk mund të cilësohet i të njëjtit identitet si boshnjakët edhe goranët, siç nuk mund të jenë njësoj shqiptarët dhe serbët.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigjen drejtorja e KQZ-së, Nesrin Lushta dhe kryeshefi i ekzekutivit të KQZ-së, Xhemajl Peqani.

Pas një debati që u zhvillua për këtë pikë, Komisioni vendosi ta procedojë Raportin për shqyrtim në njërin nga seancat plenare.

Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetari – I ftoi anëtarët për debat rreth amendamenteve duke i referuar atyre që janë diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar. Mund t'u referohemi edhe komenteve të Zyrës ndërlidhëse, gjithashtu kërkojmë edhe ndihmën e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 1 i Projektligjit “ Personi i afërt me zyrtarin “ mbetet si në Projektligj me ndryshimin që në vend të “ adoptuesi - i adoptuari “ të riformulohet “ birësuesi ose adoptuesi ”.

Adem Hajdaraj – Propozoi që formulimi “ Person i besueshëm “ të ndryshohet, “ patur “ të bëhet “ pasur”, ndërsa “apo “ të ndryshohet në “ose” duke u riformuluar si : “ Person i besueshëm është ai i cili ka ose ka pasur marrëdhënie pasurore ose biznesi me zyrtarin” .

Kryetari – Amendamenti i propozuar në mbledhjen e kaluar mbetet i pandryshuar, sa i përket paragrafit 2.2. Në rreshtin e dytë, pas fjalës qendrore të shtohen fjalët dhe “zëvendësit e tij”. Ndërsa pika 25 me përmbajtjen si vijon “ të gjithë anëtarët e bordeve të emëruar nga Kuvendi dhe Qeveria” dhe pika 25 bëhet pika 26.

Neni 3 hiqet, si dhe neni 5, pikat 10.3 dhe 10.4 . Kurse neni 6 i Projektligjit hiqet, por 12,2 mbetet si në Ligj.

Adem Hajdaraj dhe Bajram Kosumi – Propozuan që në vend të fjalës “ i afërt “ të jetë “ i afërm ”.

Kryetari – Me propozimet e ofruara të përfaqësueseve të Ministrisë së Drejtësisë riformuloi që në nenin 17.5 të Projektligjit të shtohet “ ku zyrtari ushtron autoritet vendimmarrës “ dhe riformulimi do të ishte: “Ndërmarrja në pronësi të zyrtarit, personit të afërm ose personit të besueshëm nuk ka të drejtë të lidhin kontrata ose të përfitojnë ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, ku zyrtari ushtron autoritet vendimmarrës”. Nga administrata kërkoi që nenet 9.1, 9.6 dhe 9.7 dhe neni 11 të përfshihen në kolona të Projektligjit për plotësime dhe ndryshime.

Te neni 21.6 i Projektligjit të shtohet një nen i ri 21.7 “ Për deputetët e Kosovës Agjencia do ta njoftojë Kuvendin e Kosovës se ka konflikt interesi në çështjen e caktuar. “

Adem Salihaj- Ishte i mendimit se në nenin 15 të Ligjit do të duhej të përfshiheshin edhe dy amendamente: e para “ Çdo zyrtar duhet të japë dorëheqje të qartë dhe të paravokueshme nga posti tjetër, që krijon konflikt interesi në bazë të këtij ligji “ dhe amendamenti i dytë “ Ngrirja e postit nuk konsiderohet dorëheqje nga posti që krijon konflikt interesi”.

Kryetari – Duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi se ne duhet ta përcjellim me këto amendamente, sepse amendamentet e propozuara është dashur të jenë të shkruara kur është shqyrtuar në parim.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit kundër korrupsionit

Komisioni u pajtua që Projektligji kundër korrupsionit i plotëson kushtet në parim për lexim të parë.

6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Riza Smaka, për rishikimin e përfundimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Komisioni u njoftua se deputeti Riza Samka është tërhequr nga kërkesa e tij drejtuar Komisionit.

7. Të ndryshme

Komisioni u pajtua që Projektligji për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, i plotëson kushtet në parim për lexim të parë, me vërejtjen rreth titullit të Ligjit.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni